


FORCIMI I MBROJTJES KLIMATIKE PËRMES BASHKËPUNIMIT (CLIMATE BRIDGES)

Konteksti

“Climate Bridges” forcon mbrojtjen e klimës në vargun malor Dinaride në Ballkanin Perëndimor, nëpërmjet krijimit të Rrjetit Dinarik të Klimës (DCN), i cili mbështet zbatimin e Axfordës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor (në përputhje me Green Deal të BE) në nivel lokal dhe rajonal. Ky rrjet përfshin një sërë palësh të interesuara dhe nxit shkëmbimin dhe diskutimin mes organizatave të shoqërisë civile (OSHC) dhe organeve (gjysmë) qeveritare. Projekti ndërtohet mbi përvoja të mëparshme të zbatuara me sukses në Alpe, si Partneriteti Alpin për Veprim Lokal Klimatik ose Bordi i Klimës Alpine.



Objektivat e Projektit

Objektivat e projektit janë:

- Krijimi i Rrjetit Dinarik të Klimës për të nxitur qeverisjen ndërkombëtare klimatike;
- Identifikimi i praktikave të mira për të krijuar një përmbledhje të nismave/projekteve që janë në vazhdim si dhe për të mbledhur palë të interesuara për themelimin e DCN;
- Zhvillimi i strategjive të zbutjes së efekteve të klimës dhe koncepteve të zbatimit për rajonet pilot në Dinaride;
- Njohja e OSHC-ve kombëtare/rajonale dhe organeve (gjysmë) qeveritare me rekomandimet për përmirësimin e qeverisjes ndërkombëtare të klimës në Dinaride, duke i fuqizuar dhe motivuar ato për të nxitur bashkëpunimin përtej kufijve.

Produktet

- Memorandum Bashkëpunimi mbi DCN mes të paktën 40 OSHC-ve dhe organeve (gjysmë) qeveritare të Dinarideve;
- 30 praktika të mira, në përputhje me Green Deal të Ballkanit Perëndimor, hyjnë në konkurs dhe prezantohen në një ceremoni çmimesh;
- 5 strategji për zbutjen e efekteve të klimës dhe koncepte zbatimi në rajone pilot, elaboruar së bashku me OSHC-të, organet (gjysmë) qeveritare dhe me mbështetjen e rajoneve të binjakëzimit në Alpe;
- Njohuri të reja dhe frymëzim për të 60 palët e përfshira, përmes vlerësimit të kuadrit institucional dhe rregullator për mbrojtjen e klimës në Dinaride.
- Plani i Ndërtimit të Ekonomisë së Rimëkëmbur.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)

PARTNERËT:

- CIPRA International Lab GmbH
- Instituti i Kërkimeve Urbane (URI)
- CENER 21- Center for Energy, Environment and Resources
- Association Green Istria

KOHËZGJATJA:

01/09/2021 - 01/03/2024

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (URI) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

